

20140441303

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

### Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13 dhe 164/13), në nenin 51 në paragrafin (1) pas pikës a) shtohet pikë e re b), si vijon:

“b) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është kumtuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;”.

Pika b) e cila bëhet pika v) ndryshohet si vijon:

“v) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1;”.

Pas pikës v) e cilat bëhet pika g) shtohen dy pika të reja d) dhe gj), si vijojnë:

“g) të posedojë njëren nga certifikatat apo dëshmitë vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë;
  - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë;
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2);
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë;
  - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
  - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- gj) ta ketë dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.”

### Neni 2

Në nenin 52 në paragrafin (1) pas fjalëve: “në pajtim me” shtohen fjalët: “këtë ligj”.

Pas paragrafit (4) shtohen pesë paragrafë të rinj (5), (6), (7), (8) dhe (9), si vijojnë:

“(5) Të punësuarit në Agjenci, përveç kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve, të cilët kryejnë punë administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

(6) Për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës të nëpunësve administrativë në Agjenci, e të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj dhe me marrëveshje kolektive, zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë.

(7) Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse kanë status të personelit ndihmës-teknik.

(8) Për personelin ndihmës-teknik të Agjencisë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës.

(9) Mënyra e përcaktimit të rrogës bazë dhe të shtesave të rrogës së të punësuarve në Agjenci rregullohet me marrëveshje kolektive, kurse vlerën e pikës së rrogës themelore e rregullon Këshilli i Ekspertëve.”

### Neni 3

Në nenin 52-a paragrafi (1) pika l) ndryshohet si vijon:

“l) krijon politika dhe strategji nga fusha e menaxhimit me resurse njerëzore në Agjenci;”

Pas pikës l) shtohen katër pika të reja m), n), nj) dhe o), si vijojnë:

“m) miraton plan vjetor për punësim;

n) miraton program vjetor për trajnime;

nj) përcakton kodeks për të punësuarit në Agjenci dhe

o) kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe Statutin e Agjencisë.”

Neni 4

Statuti i Agjencisë dhe aktet për zbatim të këtij ligji do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej nëntë muajve nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 5

Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë të emëruar para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdojnë ta kryejnë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 6

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nga neni 2 të këtij ligji me të cilin shtohet paragraf i ri (5) në nenin 52 do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për nëpunës administrativë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/14) dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 27/14).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.